



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri



100 Vjet Pavarësi

Nr. 2474/9 Prot.

Tiranë, më 21/11/2012

Lënda: Urdhër për kontrolluesin *Gazeta Shqiptare-Redaksia, Tiranë*

U R D H E R
Nr 06, datë 21/11 2012

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr.225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të Kontrolluesit *Gazeta Shqiptare*;

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhërit nr.127, datë 20.07.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar inspektim administrativ pranë kontrolluesit, *Gazeta Shqiptare* me objekt:

- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale sipas Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe Udhëzimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Nr.9, datë 15.09.2009 "Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive" në lidhje me publikimet online që kanë lidhje me subjektin e të dhënave personale, z.

Shtetasi _____ ka paraqitur ankesë pranë Zyrës së Komisionerit në lidhje me artikullin "Përgjimet ambientale zbardhin korrupsionin në Universitete" të publikuar nga Gazeta Shqiptare në faqen e vet zyrtare www.balkanweb.com. Ankesa konsiston në mbajtjen aktive (online) të këtij artikulli ku shtetasi i sipërcituar përmendet si kallëzues me identitet të plotë.

Artikulli me lidhjen përkatëse:

"<http://www.balkanweb.com/gazetav5/newsadmin/preview.php?id=78748>"

mban datën e publikimit 19.05.2010 dhe rezulton aktiv në arkivën elektronike të Gazetës Shqiptare.

Në këtë artikull z. _____ përmendet si kallëzues pranë organeve të policisë gjyqësore në lidhje me veprime korruptive që kryen në Universitetin Bujqësor të Kamzës.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ, i nënshkruar rregullisht nga palët, pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara në dosje vëren se:

Fillimisht, kontrolluesi Gazeta Shqiptare duhet të ketë parasysh parimet e mëposhtme në ushtrimin e veprimtarisë:

Liria e shtypit konsiderohet si thelbësore në një shoqëri të lirë dhe demokratike. Liria e informacionit bazohet në lirinë e manifestimit të mendimit, në lirinë e komunikimit, por kjo s'do të thotë të konsiderohet e të trajtohet si një interes mbizotërues i gazetarit.

Transparenca nuk mund të shuajë (fshijë) nevojën për intimitet dhe mbi të gjitha të drejtën e ndërtimit lirisht të sferës private të gjithsecilit për zhvillimin lirisht të personalitetit si dhe të respektimit të dinjitetit. Karta Evropiane e të drejtave të njeriut hapet pikërisht me vlerësimin më solemn "Dinjiteti njerëzor është i padhunueshëm, ai duhet të jetë i respektuar dhe i mbrojtur".

Në këtë kuptim, kushdo që përpunon të dhëna personale vetëm për qëllime gazetarie, literature ose artistike, do të ndeshet në radhë të parë me të drejtën e individit, subjekti i këtyre të dhënave personale, për t'i mbrojtur ato.

Ruajtja e konfidencialitetit (fshehtësi, afërsi, familjaritet, besim) si një e drejtë themelore e individit për mbrojtjen e të dhënave të tij, nuk duhet të dalë si një pengesë e dorës së dytë, ndaj të drejtës së lirisë së shprehjes së gazetarit apo çdo subjekti tjetër të parashikuar sipas këtij neni. Është e vërtetë se liria e shprehjes nuk i nënshtrohet censurës paraprake, por kjo censurë nuk ka të bëjë me mospasjen e të drejtës së individit për të mbrojtur të dhënat e tij personale. Duhet pasur parasysh që e drejta e jetës private të përshtatet me rregullat që rregullojnë lirinë e të shprehurit.

Në bazë të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar **Neni 2 Parimi i përgjithshëm** "*Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private*";

Ndërkohë, sipas Nenit 5 : Mbrojtja e të dhënave personale bazohet :*(c) të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim; d) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.*

Parimi i përcaktuar veçanërisht në pikën "c" të nenit 5 ka të bëjë me atë që kontrolluesit nuk duhet të mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale që nuk nevojiten për qëllimet e tyre. Ata nuk duhet të mbledhin të dhëna personale thjeshtë sepse duhet të mendojnë që këto të dhëna "mund të nevojiten" në të ardhmen. Ata duhet të grumbullojnë dhe përpunojnë vetëm të dhënat të cilat u nevojiten. Pra, duhet të grumbullojnë gjithshka që u nevojiten por jo më shumë se sa kanë nevojë. Në rastin konkret, **në këndvështrim të këtij parimi të dhënat identifikuese që kanë të bëjnë me kallëzuesin** duket se janë të tepërta dhe në tejkallim të këtij parimi për shkak se interes publik paraqet identiteti i personave të akuzuar dhe nën hetim që ushtrojnë funksione publike dhe jo kallëzuesi.

Ndërkohë, në Udhëzimin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Nr.9, datë 15.09.2009 “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive” i dalë në zbatim të ligjit dhe i detyrueshëm për zbatim nga të gjithë kontrolluesit publikë edhe privatë, të medias së shkruar dhe asaj vizive **Kreu III, Mbrojtja në procedimet penale, Pika 6 parashikon se:** “Nuk duhet zbuluar identiteti i dëshmitarëve, me përjashtim të rastit kur këta persona kanë dhënë më parë miratimin e tyre, kur identifikimi i dëshmitarëve është në interesin e publikut, ose dëshmia ka qenë bërë publike më parë. Në mënyrë të veçantë nuk duhet të zbulohet identiteti i dëshmitarit kur mund të vijë si pasojë vënia në rrezik e jetës ose e sigurisë së tij. Duhet respektuar masat e parashikuara nga programet e mbrojtjes për dëshmitarët, sidomos në procedimet penale që kanë lidhje me krimin e organizuar ose me vepra penale me karakter ndërfamiljar”.

Në zbatim të këtij parashikimi ligjor;

- 1.Z. nuk ka dhënë pëlqimin(miratimin) e tij për zbulimin e identitetit në media.
- 2.Në rastin konkret për denoncimin e fenomenit të korrupsionit në UBT zbulimi i identitetit të kallëzuesin nuk përbën interes publik, pasi qëllimi i artikullit ka qenë goditja e korrupsionit dhe nuk ka rëndësi për interesin publik identiteti i plotë i personit që bën denoncimin dhe artikulli mund të mjaftohet vetëm më ilustrimin e rolit që ky person ka patur në zhvillimin e ngjarjes korruptive.
- 3.Nuk ka prova që ky denoncim nga ana e z. të jetë bërë publik më parë.

Për sa më sipër parashtruar, kontrolluesi Gazeta Shqiptare rezulton të jetë në shkelje të këtij parashikimi ligjor duke publikuar identitetin e plotë të dëshmitarit në ngjarje.

Në këto kushte:

Në zbatim të neneve 27-30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

URDHËROJ

1. Në zbatim të nenit 5, nenit 30 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Nr.9, datë 15.09.2009 “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive” **kontrolluesi, Gazeta Shqiptare të bëjë fshirjen ose anonimizimin e të dhënave identifikuese të shtetasit në të gjitha artikujt ku ai rezulton si kallëzues në lidhje me ngjarjen e trajtuar në pjesën arsyetuese të këtij Urdhëri.**
2. Kryerja e këtij detyrimi të rëndësishëm ligjor të kryhet brenda një afati kohor prej 5 (pesë) ditësh.
3. Për plotësimin e këtij detyrimi te njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

4. Me kalimin e këtyre afateve në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, sipas të cilit... *“Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”*.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI
Flora ÇABEJ (POGAÇE)

Në mungesë dhe me porosi

